



Funded by
the European Union



RAPORTI VJETOR PËR AFTËSINË E KUFIZUAR

Kosova Gjithëpërfshirëse



DHJETOR, 2021

DUKAGJIN KELMENDI & REFIK JAJAGA
Kontributet: HANDIKOS, SHKSH dhe SHVK

Ky raport është pjesë e projekti të mbështetet nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë

“Promovimi gjithëpërfshirës në proceset konsultative për reformat e qeverisjes dhe administratës publike në sektorin e aftësisë së kufizuar në nivel lokal, nacional dhe regjional”

Zbatohet nga HANDIKOS, në partneritet me Disability Partnership Finland, Threshold, Shoqatën Kosovare të Shurdhërve dhe Shoqatën e të Verbërve të Kosovës

“Raporti Vjetor për vitin 2021” është prodhuar me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian. Përmajtja e tij është përgjegjësi e vetme e HandiKOS-it dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkimit Evropian.”

Përmbajtja

Akronimet	3
Hyrja	4
Përmbledhja ekzekutive	5
Fushat e Intervenimit dhe Aktivitetet.....	8
COVID 19.....	8
Qasja.....	10
Arsimi.....	12
Shëndetësia	14
Punësimi dhe kujdesi social	16
Pjesëmarrja publike	18
Zhvillime të tjera.....	19
Rekomandimet.....	20

A K R O N I M E T

BE – Bashkimi Evropian

DPF - Disability Partnership Finland

FKAK - Forumi Kosovar i Aftësisë së Kufizuar

HANDIKOS - Shoqata e Paraplegjikëve dhe e Paralizës së Fëmijëve të Kosovës

IKSHPK - Instituti Kombëtare i Shëndetësisë Publike të Kosovës

KDPAK - Konventa mbi të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar

MASHTI - Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Inovacionit

MFPT - Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve

MMPHI – Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës

OBSH - Organizata Botërore e Shëndetësisë

OKB - Organizata e Kombeve të Bashkuara

OPAK - Organizatat e Personave me Aftësi të Kufizuar

PAK - Persona me Aftësi të Kufizuara

QBMK - Qendra Burimore për Mësim dhe Këshillim

SHKSH - Shoqata Kosovare e të Shurdhërve

SHVK - Shoqata e të Verbërve të Kosovës

SHSKUK - Shërbimi Spitalor Klinik Universitar i Kosovës

UNICEF - United Nations Children's Fund

ZQM - Zyra për Qeverisje të Mirë

Hyrje

Raporti vjetor për Aftësinë e Kufizuar është përgatitur në kuadër të projektit të mbështetur nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë “Promovimi gjithëpërfshirës në proceset konsultative për reformat e qeverisjes dhe administratës publike në sektorin e aftësisë së kufizuar në nivel lokal, nacional dhe regjional”, tutje “Kosova Gjithëpërfshirëse”, i cili zbatohet nga HANDIKOS, në partneritet me Disability Partnership Finland, Threshold, Shoqatën Kosovare të Shurdhërve dhe Shoqatën e të Verbërve të Kosovës.

Në referencë të priturave dhe objektivave specifike të projektit, një Raport Vjetor për aftësinë e kufizuar do të përgatitet dhe publikohet çdo vit të Projektit, gjithmonë duke u bazuar në të gjeturat e raportit të hulumtimit lidhur me Studimin e legjislacionit aktual në Kosovë. Raporti i hulumtimit “Ku qëndron Kosova?”, është zhvilluar gjatë vitit 2019 dhe është publikuar në fillim të vitit 2020, dhe mund të gjendet në gjuhën Shqipe, Angleze dhe Serbe në ueb faqen e HANDIKOS: <http://www.handi-kos.org/>.

Qëllimi i publikimit të raportit të hulumtimit ishte dhe mbetet që Organizatat e personave me aftësi të kufizuara së bashku me institucionet publike të përdorin të dhënat e raportit për të avancuar agjendën e çështjeve të aftësisë së kufizuar dhe për të garantuar standarde të pranueshme krahas kërkesave të legjislacionit dhe politikave evropiane. Në këtë kontekst gjatë vitit 2021, OPAK-ët i kanë intensifikuar veprimet e tyre me qëllim që të avancohen çështjet që lidhen me fushat e identifikuar në këtë raport. Në bazën e të gjeturave të raportit të Hulumtimit, Organizatat e Personave me Aftësi të Kufizuara rekomandojmë që institucionet qeveritare të nivelit qendror dhe lokal të sigurojnë zbatimin e kornizës ligjore aktuale dhe aprovimin e legjislacionit plotësues për të drejtat e personave me aftësi të kufizuar në harmoni me standardet ndërkombëtare dhe të legjislacionit evropian për aftësinë e kufizuar.

Raporti i Hulumtimit lidhur me Standardet Ndërkombëtare mbi Çështjet e Aftësisë së Kufizuar ‘Ku qëndron Kosova?’, ka identifikuar dhjetë (10) fusha kryesore që përmbajnë standardet ndërkombëtare në fushën e aftësisë së kufizuar të cilat janë nxjerr nga Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, por, informatat në këtë raport për vitin 2021, janë të fokusuara në aktivitetet dhe veprimet e ndërmarra nga Organizatat e Personave me aftësi të kufizuara në 5 fusha si: Qasshmëria, Edukimi, Shëndetësia, Punësimi dhe kujdesi social, dhe Pjesëmarrja publike.

Raporti vjetor i Aftësisë së Kufizuar 2021 do të mbulon aktivitetet, veprimet dhe rezultatet e arritura në fushat të cilat janë vlerësuar si më të rëndësishme për të avancuar pozitën e personave me aftësi të kufizuara dhe respektimin e të drejtave të tyre, kjo nënkupton edhe çështjet të cilat janë të përfshira në Strategjinë Nacionale të Aftësisë së Kufizuar si dhe në Strategjinë Evropiane për aftësinë e kufizuar.

Të dhënat për çështjet për të cilat raportohet në këtë dokument janë gjeneruar nga raportet të cilat organizatat partnere të Projektit “Kosova Gjithëpërfshirëse” i dorëzojnë në baza mujore, monitorimi i kryer nga stafi i projektit, ueb faqet e organizatave partnere si dhe nga takimet me palët e ndryshme të interesit.

Përmbledhje Ekzekutive

Projekti i mbështetur nga BE “Kosova Gjithëpërfshirëse” synon të ketë një ndikim në çështjen e aftësisë së kufizuar në Kosovë me tendencën e pritur për arritjen e një “Shoqëria gjithëpërfshirëse në të cilën personat me aftësi të kufizuara realizojnë potencialin e tyre të plotë dhe jetojnë jetë me dinjitet si qytetarë të barabartë. (Strategjia Kombëtare për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara 2013-2023)”. Për të realizuar këtë ndikim, njëra nga objektivat specifike të projektit është që “Reformat Qeveritare dhe të Administratës Publike të jenë gjithëpërfshirëse”. Prandaj me qellim të arritjes së këtij rezultati, synimi i projektit është që përveç tjerash të rrisë disponueshmërinë e të dhënave për çështjet e aftësisë së kufizuar me qellim që institucionet publike dhe OPAK-ët të mund të përdorin të dhëna të besueshme si mjete për planifikim, monitorim dhe përfshirjen e iniciativave specifike për aftësinë e kufizuar.

Për shkak të pandemisë COVID 19 dhe në harmoni me masat e Qeverisë së Kosovës, Projektit “Kosova Gjithëpërfshirëse” dhe Organizatave të Personave me Aftësi të kufizuara të cilat janë partnere të Projektit iu është imponuar që edhe gjatë vitit 2021 të adaptojnë planet për zbatimin e programeve të tyre në harmoni me këto masa. Kjo ka ndikuar që disa aktivitete të planifikuara të mos zbatohen apo të shtyhet zbatimi i tyre kurse të tjerat ose shumica prej tyre të zbatohen duke improvizuar format dhe mënyrat e zbatimit të tyre. Në Kosovë, OPAK-ët kanë reaguar në fushën e shëndetësisë, qasshmërisë, edukimit-arsimit dhe mirëqenies socio ekonomike për personat me aftësi të kufizuar me qëllim që masat qeveritare kundër COVID 19 të jenë gjithëpërfshirëse dhe të adresojnë edhe nevojat e komunitetit të aftësisë së kufizuar. Duhet theksuar se për shkak të pandemisë COVID 19, shumë intervenime të Organizatave të Personave me Aftësi të Kufizuara janë bërë për të përkrahur anëtarët e tyre që përballojnë vështirësitë e shkaktuara nga pandemia, për ti informuar lidhur me parandalimin e virusit dhe për masat qeveritare kundër pandemisë, prandaj COVID 19, do të përfshihet në këtë raport edhe pse nuk është një nga fushat e hulumtuara në raportin e hulumtimit.

Në raportin e vitit 2021, do të prezantohen intervenimet e Organizatave të Personave me Aftësi të Kufizuara (OPAK) të cilat janë bërë në 5 nga 10 fushat e identifikuara në raportin e hulumtimit, përfshirë këtu si të parën në renditje edhe intervenimet në lidhje me pandeminë Covid 19, ose si në vijim: (1) Covid 19, (2) Qasshmëria, (3) Edukimi, (4) Shëndetësia, (5) Punësimi dhe kujdesi social, dhe (6) Pjesëmarrja publike.

Me gjithë vështirësitë të cilat janë shfaqur gjatë vitit 2021 si rezultat i pandemisë, me siguri të plotë mund të konstatohet se bashkëpunimi i Organizatave të Personave me Aftësi të Kufizuara me përfaqësuesit e institucioneve publike dhe qeverisë asnjëherë nuk ishte më i madh, së paku sa i përket rezultateve të arritura, filluar nga krijimi i “Këshillit për Aftësinë e Kufizuar” në Qershor 2021, Aprovimi i “Planit të Veprimit për Aftësinë e Kufizuar 2021-2023” në Shtator 2021 dhe së fundi, në Dhjetor 2021, “Vendimi i Qeverisë së Kosovës që të shpall vitin 2022, vit të personave me aftësi të kufizuara”. Të gjitha këto rezultate janë arritur në bashkëpunim të plotë dhe bashkëveprim me Zyrën për Qeverisje të Mirë (ZQM).

Lidhur me këtë të fundit, bashkëpunimi dhe bashkëveprimi me Zyrën për Qeverisje të Mirë (ZQM) ka rezultuar edhe me hartimin e **“Kalendarit të aktiviteteve për vitin 2022”**, një dokument ky i hartuar me kontributin e Organizatave të Personave me Aftësi të Kufizuara (HandiKOS; Shoqata Kosovare e të Shurdhërve; Shoqata e të Verbërve të Kosovës; Down Sindrom Kosova; Autizmi; dhe Forumi Kosovar i Aftësisë së Kufizuar) dhe përfaqësuesve të Ministrive relevante (Ministria e Shëndetësisë; Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve; Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacioneve; Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës; Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal;

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit; Ministria e Drejtësisë; dhe Policia e Kosovës). Për të hartuar “Kalendarin e aktiviteteve për vitin 2022” Projekti i mbështetur nga BE “Kosova Gjithëpërfshirëse” dhe Zyra për Qeverisje të Mirë (ZQM) kanë organizuar shtatë (7) punëtori njëditore në të cilën morën pjesë përfaqësuesit e Organizatave të Personave me Aftësi të Kufizuara dhe të Ministrive të lartpërmendura.

“Kalendari i aktiviteteve për vitin 2022” është aprovuar si aneks dokument i Vendimit të Qeverisë së Kosovës me të cilin shpall vitin 2022, vit të personave me aftësi të kufizuara”, për më tepër, në këtë vendim Qeveria e Kosovës kërkon nga të gjitha Ministrinë e lartpërmendura që të zbatojnë aktivitetet e planifikuara dhe prezantuar në këtë dokument.


E arritur tjetër gjatë vitit 2021 dhe me rëndësi të madhe për zhvillimet në fushën e Aftësisë së Kufizuar në Kosovë e që po ashtu është rezultat i bashkëpunimit të ngushtë të Organizatave të Personave me Aftësi të Kufizuara me Zyrën për Qeverisje të Mirë (ZQM) është **themelimi i Këshillit të Aftësisë së Kufizuar**. Vendimi i Qeverisë së Kosovës për themelimin e këtij Këshilli është sjellë me datën 26 Qershor 2021 si organ këshillëdhënës dhe orientues mbi përcaktimin e prioriteteve dhe politikave në fushën e Aftësisë së Kufizuar, organ i cili mund të inicioj dhe të marr pjesë aktive në hartimin dhe zhvillimin e politikave të reja që kanë të bëjnë me çështjet e aftësisë së kufizuar dhe ti propozoj rekomandime Qeverisë së Republikës së Kosovës. Sipas vendimit të Qeverisë, Kryesues e Këshillit është Zëvendëskryeministria e Kosovës, Znj. Emilija Rexhepi, Bashkë-Kryesues është Kryetari i Forumit të Aftësisë së Kosovës, Zt. Bujar Kadriu, Zëvendës Kryesues është Drejtori i Zyrës për Qeverisje të Mirë, Zt. Habit Hajredini kurse anëtarë janë Zëvendës Ministrat (Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve; Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacioneve; Ministria e Shëndetësisë; Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal; dhe Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës) dhe drejtuesit e Organizatave të Personave me Aftësi të Kufizuara (HandiKOS; Handicap Kosova, Shoqata Kosovare e të Shurdhërve; Shoqata e të Verbërve të Kosovës; Down Sindrom Kosova dhe Shoqata Autizmi).

Me datën 22 Shtator 2021, megjithëse kishte kërkuar mjaftë kohë për arsye të procedurave brenda organeve relevante për miratim të strategjive dhe planeve të punës, Qeveria e Kosovës ka marr vendimin me të cilin aprovohet **“Plani i Veprimit për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar në Republikën e Kosovës 2021-2023”** në kuadër të Strategjisë Nacionale për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara në Republikën e Kosovës 2013-2023. Me të njëjtin vendim obligohen të gjitha institucionet përgjegjëse për zbatimin e Planit të Veprimit kurse Zyra për Qeverisje të mirë do të koordinon dhe monitoron zbatimin e planit. Edhe ky dokument me rëndësi për fushën e aftësisë së kufizuar është produkt i punës së përbashkët në mes të Organizatave të Personave me Aftësi të Kufizuara dhe Ministrive relevante dhe i tërë procesi i hartimit është kryer nga Zyra për Qeverisje të mirë me mbështetje të Projektit “Kosova Gjithëpërfshirëse” i cili financohet nga BE.

Megjithëse gjatë vitit 2021, të gjitha Organizatat e Personave me Aftësi të Kufizuara kanë marr pjesë në takime dhe punëtori me MFPT dhe gjatë tyre kanë kontribuar në hartimin e draftit final të **“Ligjit Gjithëpërfshirës për Aftësinë e Kufizuar”**, ai për arsye procedurale nuk është dorëzuar ende për aprovim pranë Kuvendit të Kosovës, prandaj, duke marr parasysh rëndësinë, fushat të cilat pritet ti rregullojë dhe nevojat që do të mbuloj ky ligj, aprovimi i tij mbetet një ndër çështjet kryesore për të cilën Organizatat e Personave me Aftësi të Kufizuara do të avokojnë gjatë vitit 2022.


Standardet e hulumtimit

FUSHAT E HULUMTIMIT



- E drejta për jetë dhe drejtësi
- Pavarësia, privatësia, familja dhe jeta në komunitet
- Qasja
- Arsimi
- Liria, mbrojtja nga tortura, integriteti dhe lëvizja
- Barazia, mosdiskriminimi (gratë dhe fëmijë)
- Shëndeti
- Punësimi dhe kujdesi social
- Pjesëmarrja publike
- Statistikat dhe bashkëpunimi ndërkombëtar

FUSHAT E INTERVENIMIT-2021



Fushat e Intervenimit dhe Aktivitetet

Të dhënat në vijim të këtij raporti janë paraqitur më shumë si përshkruese të aktiviteteve të realizuara apo rezultateve të arritura, pra ato nuk përmbajnë të dhëna kualitative të zbatimit të ligjeve në praktikë apo analiza detale lidhur me ndikimin e tyre në jetën e personave me aftësi të kufizuara. Një raport detal lidhur me zbatimin e legjislacionit aktual do të mund të na ofronte të dhëna kualitative lidhur me zbatimin në praktikë të këtyre standardeve dhe ndikimin që kanë në jetën e personave me aftësi të kufizuara. Hulumtime kualitative në këtë kontekst do të bëhen viteve në vazhdim.

1. COVID 19

Gjatë vitit 2021, pandemia e COVID-19 ka përkeqësuar më tej pabarazitë sociale dhe ka krijuar barriera shtesë për personat me aftësi të kufizuara sidomos kur bëhet fjalë për qasje në shërbimet e kujdesit shëndetësor, punësim e në veçanti të përcjellja e rregullt e programit arsimor për fëmijët me aftësi të kufizuara.

Sipas ligjeve aktuale të Kosovës për të drejtat e personave me aftësitë e kufizuara, personat me aftësi të kufizuara duhet të kenë qasje në kujdesin shëndetësor, arsim dhe punësim, prandaj këto të drejta që garantohen me ligjet aktuale duhet të mbrohen dhe të akomodohen edhe gjatë periudhave të emergjencave të tilla si kriza e shkaktuar nga pandemia lidhur me virusin Covid 19. Kufizimi ose mohimi i këtyre të drejtave është në kundërshtim të drejtpërdrejtë me Ligjin kundër diskriminimit që gjendet brenda Kushtetutës së Republikës së Kosovës, i cili thekson se të gjithë personat kanë të drejta të barabarta, ndër të tjera, për kujdesin shëndetësor, arsimin dhe punësimin. Kufizimi ose mohimi i këtyre të drejtave është gjithashtu në kundërshtim të drejtpërdrejtë me Konventën e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (UNCRPD) si dhe me legjislacionin dhe standardet e BE, në të cilën Kosova synon të anëtarësohet.

Të gjitha hulumtimet tregojnë se, edhe kur bota nuk përjeton ndonjë pandemi globale, personat me aftësi të kufizuara kanë nevojë më të mëdha për kujdesin shëndetësor dhe kanë më shumë gjasa të përjetojnë keqësim të gjendjes së tyre shëndetësore nëse shërbimet e kujdesit shëndetësorë mungojnë apo nuk ofrohen në mënyrë të duhur dhe sasi të mjaftueshme, e njëjta vlen edhe për arsimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara, ata edhe në rrethanat kur nuk kishte fare masa mbrojtëse lidhur me pandeminë ballafaqoheshin me vështirësi dhe pengesa të ndryshme për ndjekjen e rregullt të programit shkollor. Me aplikimin e masave anti-covid vështirësitë u shumëfishuan, duke filluar nga transporti deri në shkolla, komunikimi dhe qasja në informata, asistimi gjatë procesit mësimor, etj. Situata e krizës e krijuar nga pandemia kishte efekt negativ edhe në punësimin e personave me aftësi të kufizuara, vështirësitë që pandemia krijoi për ekonominë e vendit rezultuan që punësimi i personave me aftësi të kufizuara të vendoset në plan të dytë, duke bërë kështu që aplikimi i ligjit të punësimit dhe kuotës së punësimit të personave me aftësi të kufizuara që del nga ky ligj të mos respektohen.

Organizatat të cilat përfaqësojnë personat me aftësi të kufizuara në Kosovë edhe gjatë vitit 2021 kanë avokuar duke apeluar te institucionet publike për rëndësinë që nevojat e personave me aftësi të kufizuara të mos injorohen gjatë pandemisë, në të njëjtën kohë është përsëritur nevojat që organizatat e personave me aftësi të kufizuara duhet të konsultohen dhe të përfshihen në të gjitha planet dhe politikat që kanë të bëjnë me krizën aktuale të shkaktuar nga pandemia, dhe kjo, jo vetëm me qëllim të prezantimit të nevojave dhe vështirësive me të cilat ballafaqohen personat me aftësi të kufizuara por edhe të

propozimeve që organizatat mund të ofrojnë në zgjidhjen e këtyre vështirësive dhe përkrahjen konkrete të realizimit të tyre.

Aktivitetet e Organizatave të personave me aftësi të kufizuara për informimin adekuat dhe me kohë si dhe vetëdijesimin e anëtarëve të tyre kanë vazhduar gjatë tërë vitit 2021, ato kishin të bënin me masat për mbrojtje nga infektimi me Covid 19 kurse më pas edhe me instruksionet për procesin e vaksinimit dhe përfshirjen e tyre në numër sa më të madh në këtë proces.

Gjatë vitit 2021, organizatat e personave me aftësi të kufizuara të cilat janë edhe ofruese të shërbimeve për anëtarët e tyre, sikur në këtë rast HandiKOS, Shoqata e të Shurdhërve të Kosovës dhe Shoqata e të Verbërve të Kosovës, kanë punuar në zhvillimin dhe zbatimin e planeve të vazhdimësisë së ofrimit të shërbimeve duke ndërmarr masa për reduktimin e ekspozimit të mundshëm ndaj COVID-19 të përfituesve gjatë pranimit të atyre shërbimeve dhe kanë ofruar mbështetje të vazhdueshme për personat me aftësi të kufizuara dhe familjarët e tyre.

HANDIKOS, gjatë periudhave të caktuara kohore kur masat e Qeverisë kundër Covid 19 kufizonin lëvizjen e lirë dhe kontaktet fizike ka vazhduar mbështetjen për personat me aftësi të kufizuara virtualisht përmes mediave sociale dhe platformave të tjera online, ndërsa, kur masat zbuteshin dhe lejonin lëvizjen, HANDIKOS duke adaptuar kushtet e punës dhe duke shtuar masat mbrojtëse nga përhapja e virusit ofronte shërbimet për personat me aftësi të kufizuara edhe në formën fizike, sidomos shërbimet të cilat kanë të bëjnë me rehabilitimin fizik dhe psiko-social të fëmijëve me aftësi të kufizuara, të vlerësuara më se të nevojshme për shëndetin e tyre. Në anën tjetër, me gjithë vështirësitë që kaluam gjatë vitit 2021, mbulimi i nevojave të personave me aftësi të kufizuara me pajisje të ndryshme ndihmëse nuk është ndalur asnjëherë. Për më tepër, HANDIKOS duke bërë shpërndarjen e pajisjeve ndihmëse ka përkrahur edhe institucionet publike, sikur që ishte rasti kur HANDIKOS i dorëzoi Shërbimet Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës (SHSKUK) një donacion prej 40 pajisjesh ndihmëse, si karroca me rrota, shëtitore dhe paterica, të cilat do t'u shërbejnë klinikave për të mbuluar nevojat e qytetarëve që marrin shërbime atje si dhe rasti kur HANDIKOS i dorëzoi si donacion 3 karroca qendrës së vaksinimit në Prishtinë.

Shoqata Kosovare e të Shurdhërve edhe gjatë vitit 2021 ndërmori veprime të shumta për tu kujdesur që anëtarët e saj janë mirë të informuar duke ju ofruar qasje në informatat më të reja përmes gjuhës së shenjave. Me përkrahje të Qeverisë së Kosovës, interpretimi i gjuhës së shenjave sigurohej në konferencat për shtyp të organizuara nga Ministria e Shëndetësisë si dhe në lajmet e Televizionit publik. SHKSH me përkrahje të Forumit Kosovar të Aftësisë së Kufizuar (FKAK) organizuan sesione të shumta informimi në lidhje me Covid 19 si dhe aktivitete me fëmijë të shurdhër përmes platformës në internet. Rezultat dhe sukses tjetër i punës së Shoqatës Kosovare të Shurdhërve gjatë vitit 2021 është finalizimi i “Fjalorit Elektronik të gjuhës së Shenjave” i cili tanimë mund të gjendet edhe në ueb faqen www.gjshk.org.

Shoqata e të Verbërve të Kosovës, gjithashtu në përpjekje për të bartur informacionin e nevojshëm tek anëtarët e saj, zhvilloi dhe përdori qasjen që përmes mediave sociale personat e verbër të jenë mirë të informuar mbi të gjitha masat lidhur me pandeminë. Po ashtu, Shoqata e të Verbërve të Kosovës ofroj vazhdimisht përkrahjen e tyre që procesi mësimor për fëmijët e verbër të mos ndërpritet.

Forumi i Kosovës për Aftësi të Kufizuara së bashku me OPAK-ët kanë organizuar takime të shumta me MASHTI, UNICEF dhe Organizata të tjera ndërkombëtare për të përkrahur me veprimet e tyre procesin arsimor për fëmijët me aftësi të kufizuara.

Gjatë vitit që po lëmë pas, kur bëhet fjalë për mbrojtjen dhe të drejtat e personave me aftësi të kufizuara dhe angazhimin e organizatave të personave me aftësi të kufizuara për të promovuar, mbrojtur dhe siguruar gëzimin e plotë dhe të barabartë të të gjitha të drejtave të njeriut për personat me aftësi të kufizuara, pa marr parasysh krizën e shkaktuar nga pandemia, janë arritur rezultate të konsiderueshme, filluar nga krijimi i “Këshillit për Aftësinë e Kufizuar” në Korrik 2021, Aprovimi i “Planit të Veprimit për Aftësinë e Kufizuar 2021-2023” në Shtator 2021 dhe së fundi, në Dhjetor 2021, vendimi i Qeverisë së Kosovës që të shpall vitin 2022, “vit të personave me aftësi të kufizuara”. Për këtë të fundit, për disa muaj me radhë, Organizatat e Personave me aftësi të kufizuara në bashkëpunim me Zyrën për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit kanë punuar me përfaqësuesit e Ministrive relevante në hartimin e kalendarit të aktiviteteve të cilat pritet të realizohen gjatë vitit 2022, aktivitete këto të identifikua si shumë të rëndësishme për avancimin e pozitës së personave me aftësi të kufizuara në Kosovë. Kalendarit të aktiviteteve për vitin 2022, i finalizuar nga të gjitha palët e interesit u aprovuar si aneks i vendimit të Qeverisë së Kosovës për shpalljen e vitit 2022 – vit i personave me aftësi të kufizuara.

2. Qasshmëria

Raporti i Hulumtimit¹, gjene se qasja është ndër kategoritë dhe standardet më të rëndësishme e cila është e përfshirë vetëm 6.77% në legjislacionin e Kosovës, ndërsa është adresuar pjesërisht 79.67%, dhe 13.55% e standardeve mungojnë ose nuk janë përfshirë fare në legjislacionin e Kosovës.

Qasja është parakusht për krijimin e një shoqërie e cila synon të ofroj mundësi të barabarta për të gjithë. Sipas hulumtimeve të bëra nga Organizatat e Personave me Aftësi të Kufizuara, në vendin tonë ekzistojnë barriera të shumta të cilat i pengojnë personat me aftësi të kufizuara të gëzojnë mundësitë e barabarta me qytetarët e tjerë, prandaj me qëllim të lehtësimin të komunikimit, qasjes në informata, mjedis fizik, transport, organizatat e personave me aftësi të kufizuar edhe gjatë vitit 2021 janë angazhuar që përmes avokimit, lobimit, takimeve dhe bashkëpunimit me institucione publike dhe private të avancojnë pozitën e komunitetit të tyre në raport me standardet e kërkuara për qasje të lirë dhe pa pengesa.

Këto angazhime përfshijnë takimin e drejtuesit të HandiKOS me Zëvendës-Ministrin e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, Zt. Hysen Durmishi, në të cilin u diskutua dhe u kërkuar zbatimi i Udhëzimit Administrativ 33/2007 për kushtet teknike të objekteve ndërtimore për qasjen e personave me aftësi të kufizuara, takimi u mbyll me zotimin e Zv. Ministrit se do të përcjellë një letër në të gjitha komunat e Kosovës me të cilën do të kërkojë zbatimin e këtij Udhëzimi.

Për të mundësuar lëvizjen e lirë dhe pavarësimin e personave me aftësi të kufizuar, HANDIKOS edhe gjatë vitit 2021 ka vazhduar me shpërndarjen e karrocave, shëtitoreve, kukëzave dhe pajisje tjera mbështetëse. Me po të njëjtin qëllim, HandiKOS gjatë këtij viti ka përkrahur edhe institucionet publike, sikur që ishte rasti kur HANDIKOS i dorëzoi Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës (SHSKUK) një donacion prej 40 pajisjesh ndihmëse si dhe rasti kur HANDIKOS i dorëzoi si donacion 3 karroca qendrës së vaksinimit në Prishtinë.

Takime në të cilat temë ishte qasja janë zhvilluar nga Shoqata Kosovare e të Shurdhërve me institucione të ndryshme në të cilat janë ngritur nevojat e komunitetit të shurdhër për qasje të barabartë në informim përmes gjuhës së shenjave. Nga takimet e tilla është arritur përkrahja e qeverisë së Kosovës që në të gjitha

¹Rozafa Basha dhe Hajrulla Çeku/ Standardet Ndërkombëtare mbi Çështjet e Aftësisë së Kufizuar ‘Ku qëndron Kosova?, Prishtine, Mars 2020

konferencat e sajë të jetë prezent interpretuesi i gjuhës së shenjave i cili do të mundësojë informimin e duhur për komunitetin e shurdhër. Mbi të gjitha, gjatë vitit 2021, Shoqata Kosovare e të Shurdhërve suksesin e sajë e ka arritur duke finalizuar “Fjalorin Elektronik të gjuhës së Shenjave” i cili është publikuar në ueb faqen www.gjshk.org. Ky fjalor i mundëson personave të shurdhër të mësojnë shenjat e caktuara të cilat përdoren nga komuniteti i tyre por në të njëjtën kohë i mundëson edhe qytetarëve të tjerë të mësojnë shenjat në mënyrë që të vendosin komunikimin me personat e shurdhër.

Gjatë vitit 2021, Shoqata e të Verbërve të Kosovës fokusin kryesor e kishte te krijimi i sintezës vokale në gjuhën Shqipe, për këtë janë zhvilluar biseda me Ministrin e Arsimit të Kosovës i cili është zotuar se në bashkëveprim me Ministrin e Arsimit të Shqipërisë do të gjejnë mënyrat e plotësimit të kësaj kërkesë e cila nga të verbrit e Kosovës vlerësohet si mjet i cili do të ndihmonte shumë qasjen e tyre në informata dhe komunikim. Krijimi i Sintezës vokale në gjuhën shqipe do tu mundësonte personave të verbër të komunitetit shqipfolës lehtësimin e komunikimit, qasje në informacion, sisteme të ndryshme, internet dhe do të krijonte lehtësira edhe në sistemin për edukimin dhe punësimin e personave të verbër. Informatat e fundit nga Shoqata e të verbërve të Kosovës na njoftojnë se nga takimet me organizatat simotra janë shtuar gjasat që në bashkëpunim me institucionet përkatëse nga Maqedonia e Veriut të krijohet sinteza vokale në gjuhën Shqipe.

Me qëllim që të eliminohen barrierat dhe të krijohen mundësit për qasje të lirë, Organizatat e Personave me Aftësi të Kufizuara në bashkëpunim me Zyrën për Qeverisje të Mirë dhe të përkrahur nga projekti i mbështetur nga BE “Kosova Gjithëpërfshirëse”, gjatë vitit 2021 në kuadër të veprimeve për hartimin e “Kalendarit të Aktiviteteve për vitin 2022” kanë organizuar punëtori me përfaqësues nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës në të cilën janë diskutuar dhe më pas planifikuar veprimet konkrete të cilat kjo Ministri do të ndërmarr gjatë vitit 2022 për të mundësuar qasjen e lirë në ambientet fizike, në transport, informata dhe komunikim, duke përfshirë edhe teknologjitë dhe sistemet e informacionit dhe komunikimit. Mbi të gjitha vlen të theksohet kërkesa e OPAK që UA 33/2007 të shndërrohet në ligj i cili do të rregullonte qasjen e personave me aftësi të kufizuara. (Detalet tjera lidhur me veprimet e planifikuara të kësaj Ministrie mund ti gjeni në Aneks 1 të këtij dokumenti Tabela e “Kalendarit të Aktiviteteve për vitin 2022”).

Për qëllimet e këtij raporti janë përfshirë detyrimet e mëposhtme:

Fushat e hulumtimit	Fusha e Intervenimit gjatë vitit 2021	Aktivitetet/Lloji i intervenimit
Qasja e barabartë në mjedis fizik, transport, TIK dhe lehtësira dhe shërbime të tjera	E aplikuar	Takime me Ministrin e MMPHI, Ministrin e MESTI si dhe punëtorja me përfaqësuesit e OPAK dhe MMPHI.
Standardet minimale dhe udhëzimet e qasjes.	E aplikuar	Kërkesa për zbatimin e Udhëzimit administrativ 33/2007. Interpretimi në gjuhën e shenjave në konferencat e organizuara nga Qeveria.
Kompanitë private heqin barrierat dhe nuk vendosin të reja	NA	
Trajnimi i palëve të interesuara relevante për qasjen e personave me aftësi të kufizuara.	NA	Planifikohet në kuadër të Projektit “Kosova Gjithëpërfshirëse” – aktivitet për vitin 2022.

Format për lehtësimin e komunikimit përmes Brail-it dhe udhëzuesve të tjerë (interpretuesit e gjuhës së shenjave).	E aplikuar	Takime lidhur me publikimin e dokumenteve zyrtare në Brail. Publikimi i fjalorit elektronik të gjuhës së shenjave.
Qasja në informacion, sisteme, internet	E aplikuar	Takime lidhur me finalizimin e Draft marrëveshjes për krijimin e Sintezës vokale në Gjuhën Shqipe në mes dy ministrive, Kosovës dhe asaj të Shqipërisë. Shërbime interpretimi për institucione publike.
Kërkesat e qasjes janë pjesë përbërëse e projekteve ndërtimore që nga faza e projektimit.	E aplikuar	Takimi me Ministrin e MMPHI në të cilën u zotua se do të dërgohet kërkesa në të gjitha komunat për zbatimin e Urdhresës Administrative 33/2007.
Organizatat e personave me aftësi të kufizuara konsultohen lidhur me standardet dhe normat e qasjes	E aplikuar	Punëtorja me përfaqësuesit e MMPHI në të cilën janë planifikuar veprimet për qasjen.
Shërbimet e mediave janë të qasshme për personat me aftësi të kufizuara	E aplikuar	Vetëm RTK ofron informata në gjuhën e shenjave (ditari)

3. Edukimi

Sipas raportit të gjeturave nga raporti i hulumtimit “Ku qëndron Kosova?”, arsimi është ndër kategoritë me rezultate të moderuara. Rreth 42% e standardeve për aftësinë e kufizuar janë të përfshira në legjislacionin e Kosovës, 50% e standardeve janë të adresuara pjesërisht, dhe vetëm 8.33% e standardeve mungojnë ose nuk janë të adresuara fare.

Me qellim të realizimit të së drejtës për arsim gjithëpërfshirës, mbështetjes individuale për nxënësit/studentët me aftësi të kufizuar dhe përmirësimit të qasjes së nxënësve në shkolla, trajnimit të mësuesve dhe profesionistëve të tjerë dhe aftësimit profesional të mësuesve, organizatat e personave me aftësi të kufizuar gjatë intervenimeve në vitin 2021, kanë organizuar takime të vazhdueshme me Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, punëtori të shumta me stafin arsimor si dhe trajnime me mësuesit e shkollave të cilët punojnë me nxënësit me aftësi të kufizuara.

Në këtë drejtim, Shoqata e të Verbërve të Kosovës, në kuadër të Projektit “Përfshirja e fëmijëve të verbër në arsimin parashkollor në Kosovë”, përkrahur nga “Swiss Cooperation” zyra në Kosovë, ka organizuar një numër të punëtorive me personelin shkollor dhe drejtuesit e institucioneve parashkollore në Komunat e Kosovës. Po ashtu, me punëtorët profesional arsimor dhe me prindërit e fëmijëve të verbër Shoqata e të Verbërve të Kosovës ka organizuar punëtori me temën “Ngritja e vetëdijes dhe njohurive për përfshirjen e fëmijëve në arsim”.

Me gjithë sukseset e arritura në fushën e arsimit dhe përdorimit të gjuhës së shenjave, Shoqata Kosovare e të Shurdhërve edhe gjatë vitit 2021 është angazhuar me tërë potencialin e saj që të përmirësojë kualitetin e arsimit për nxënësit e shurdhër. Në këtë drejtim ende mbeten sfida të cilat në bashkëpunim me MASHTI synohet të realizohen në periudhat e ardhshme kohore. Kërkesa imediate mbeten rritja e numrit të asistentëve të punësuar në shkolla ku vijojnë mësimin nxënësit me aftësi të kufizuara si dhe punësimi i asistentëve të gjuhës së shenjave në Qendrën Burimore “Nëna Terezë” në Prizren, për të

mbështetur fëmijët me dëmtime në dëgjim gjatë procesit arsimor. Kontribut të madh në drejtim të përmirësimit të kualitetit të arsimit të fëmijëve të shurdhër do të ofrojë publikimi i fjalorit të parë elektronik të gjuhës së shenjave kosovare i cili është përmendur edhe më lartë në këtë raport si një e arritur e madhe e Shoqatës së Personave të Shurdhër të Kosovës. Në përmirësimin e arsimit dhe përdorimit të gjuhës së shenjave, Shoqata Kosovare e të Shurdhërve ka mbështetur të jashtëzakonshme dhe të vazhdueshme nga Asociacioni i të Shurdhërve nga Finlanda (FAD) dhe ekspertët nga ky asociacion.

Me qëllim të gjithëpërfshirjes në arsim dhe krijimit të kushteve për fëmijët me aftësi të kufizuara që pa pengesa të përfshihen në sistemin arsimor dhe si rrjedhojë të pranojnë mësim cilësor, Organizatat e Personave me Aftësi të Kufizuara në bashkëpunim me Zyrën për Qeverisje të Mirë dhe të përkrahur nga projekti i mbështetur nga BE “Kosova Gjithëpërfshirëse”, gjatë vitit 2021 në kuadër të veprimeve për hartimin e “Kalendarit të Aktiviteteve për vitin 2022” kanë organizuar punëtori me përfaqësues nga Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit në të cilën janë diskutuar dhe më pas planifikuar veprimet konkrete të cilat kjo Ministri do të ndërmarë gjatë vitit 2022. Në këtë drejtim, në veçanti duhet përmendur disa nga zotimet kryesore të MASHTI të cilat janë në vijim: (1) se në 10 shkolla fillore dhe të mesme të ulëta në 10 komuna dhe 5 shkolla të mesme të larta në 5 komuna, të cilat nuk kanë qasje fizike për fëmijët/nxënësit me aftësi të kufizuara do të ndërtohen pjerrinat për qasje, (2) do të ngritën kapacitetet për mësimin në Brail dhe “Orientim & Mobilitet” për fëmijët e verbër në shkolla, (3) do të iniciohet procesi për krijimin e Sintezës Vokale në Gjuhën Shqipe (4) do të rritet numri i asistentëve të punësuar në shkolla (100 asistentë të punësuar) si dhe punësimi i tre asistentëve të gjuhës së shenjave në Qendrën Burimore “Nëna Terezë” në Prizren, (5) Do bëhet akreditimi i kualifikimit (niveli i 5-të) Interpret i Gjuhës së Shenjave, si dhe shumë zotime të tjera të cilat në detale janë të prezantuara në “Kalendarin e aktiviteteve për vitin 2022” dhe të cilat me siguri se do të kenë ndikim pozitiv në përfshirjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara në arsim (Shiko Aneks 1).

Për qëllimet e këtij raporti janë përfshirë detyrimet e mëposhtme:

Fushat e hulumtimit	Fusha e Intervenimet gjatë vitit 2021	Aktivitetet/Lloji I intervenimit
E drejta për arsim gjithëpërfshirës	E aplikuar	Legjislacionit aktual si dhe takimet, punëtoritë dhe trajnimet e vazhdueshme me MASHTI dhe profesionistët arsimor të cilat synojnë zbatimin e ligjeve aktuale.
Parandalimi i mohimit të së drejtës së arsimit në bazë të aftësisë	E aplikuar	Ngritja e vetëdijes lidhur me zbatimin e legjislacionit aktual për arsim gjithëpërfshirës.
Nxënësit me aftësi të kufizuara ndjekin mësim të rregullta në shkollë	E aplikuar	Takimet me MASHTI për të krijuar kushtet që fëmijët me aftësi të kufizuara të ndjekin mësim të rregullta në shkollë.
Detyrimet e shkollave për të përmirësuar qasjen për nxënësit e shkollës me aftësi të kufizuara/	E aplikuar	Takimet dhe punëtoritë e OPAK-ve me Ministrinë e Arsimit.
Parandalimi i diskriminimit të vajzave me aftësi të kufizuara në qasjen në arsim/	NA	

Mbështetja individuale për nxënësit dhe studentët	E aplikuar	Publikimi i Fjalorit elektronik të gjuhës së shenjave. Inicimi i krijimit të sintezës vokale në gjuhën Shqipe.
Punësimi i mësuesve (duke përfshirë ata me aftësi të kufizuara) që zotërojnë gjuhën e shenjave dhe gjuhën Brail.	E aplikuar	Zotimi i MASHTI për punësimin e asistentëve të cilët zotërojnë gjuhën e shenjave. *Punësimi i asistentëve është në proces.
Trajnimi i mësuesve dhe profesionistëve të tjerë për arsim gjithëpërfshirës	E aplikuar	Trajnime të vazhdueshme nga OPAK për stafin arsimor me të cilat është bërë ngritja e kapaciteteve të stafit profesional të MASHTI

4. Shëndetësia

Shëndeti është ndër kategoritë me numrin më të madh të detyrimeve (standardeve) ndërkombëtare të përfshira në legjislacionin e Kosovës (dy të tretat, 66.66%):

Sipas legjislacionit aktual në Kosovë çdo person ka të drejtën e trajtimit shëndetësor të barabartë, kjo nuk nënkupton vetëm trajtimin nga ana e personelit shëndetësor por edhe lehtësimin e qasjes në shërbimet shëndetësore. Shërbime e tilla duhet të përfshijnë shërbime mjekësore dhe të infermierisë në kujdesin spitalor, ambulatorë apo në shtëpi të bazuar në komunitet, dhe në ndihmë shëndetësore profesionale të specializuar.

Në mungesë të ofrimit të shërbimeve në komunitet për personat me aftësi të kufizuara, Organizatat sikur HandiKOS ofrojnë shërbime të rehabilitimit primar fizik si dhe të rehabilitimit psiko-social. Në të njëjtën kohë, po ashtu për arsye të mungesës së ofrimit të shërbimeve nga institucionet shtetërore, HandiKOS mbulon nevojat e personave me aftësi të kufizuara me pajisje ndihmëse (Karroca, Shëtitore, Kukëza, etj.) Për të mundësuar mbulimin e nevojave të personave me aftësi në kufizuara për pajisje ndihmëse dhe rehabilitim, drejtori i HandiKOS ka kontribuar në hartimin e Udhëzimit Administrativ, akt ky nën-ligjor i cili ka për qëllim që të rregullohet në mënyrë institucionale mbulimi i nevojave për pajisje ndihmëse dhe rehabilitim të personave me aftësi të kufizuara. Udhëzimi është finalizuar dhe i është dorëzuar për aprovim Qeverisë së Kosovës.

Megjithëse qasja fizike për hyrje në objektet shëndetësore ekziston, OPAK kanë identifikuar pengesa të tjera të cilat kanë të bëjnë me ofrimin e shërbimeve cilësore shëndetësore, këtu p.sh. bëhet fjalë për shtretërit ekzaminues të cilët nuk janë të përshtatshëm për ekzaminimin e femrave me aftësi të kufizuara si dhe mungesa e informatave në gjuhën e shenjave gjatë ofrimit të shërbimeve shëndetësore.

Me qëllim të përmirësimit të shërbimeve shëndetësore për personat me aftësi të kufizuara, OPAK në bashkëpunim me ZQM dhe të përkrahur nga projekti i BE-së “Kosova Gjithëpërfshirëse”, gjatë vitit 2021 kanë organizuar punëtori me përfaqësues të Ministrisë së Shëndetësisë për të hartuar Kalendarin e Aktiviteteve për vitin 2022 në të cilin janë vendosur veprimet konkrete që do të realizohen nga kjo ministri. Veprimet të cilat kjo ministri është zotuar se do ti realizojë kanë të bëjnë me identifikimin e hershëm të aftësisë së kufizuar, shërbime cilësore për të minimizuar dhe parandaluar përkeqësimin e aftësive të

kufizuara, informimi në gjuhën e shenjave, dhe shumë të tjera të cilat në detale mund ti gjeni në Aneks 1. të këtij dokumenti tabela e “Kalendarit të aktiviteteve për vitin 2022”.

Për qëllimet e këtij raporti janë përfshirë detyrimet e mëposhtme:

Fushat e hulumtimit	Fusha e Intervenimeve gjatë vitit 2021	Aktivitetet/Lloji i intervenimit
Objektet dhe shërbimet shëndetësore funksionale me programe dhe shërbime të përshtatshme për trajtimin e personave me aftësi të kufizuara.	E aplikuar	Është kërkuar krijimi i “Njesisë Spinale” – përfshirë në planin e veprimit dhe në kalendarin e aktiviteteve.
Objektet dhe shërbimet shëndetësore të qasshme dhe jo diskriminuese ndaj grupeve të pa favorizuara.	E aplikuar	Objektet dhe shërbimet shëndetësore në sektorin publik kanë qasje objekte.
Standarde të lidhura me të gjithë parimet e nenit 25 (sigurimi i shërbimeve shëndetësore të përshtatshme dhe të arritshme për PAK).	E aplikuar	Është kërkuar informimi në gjuhën e shenjave në objektet shëndetësore.
Shërbimet shëndetësore për personat me aftësi të kufizuara janë të përballueshme-	E aplikuar	PAK janë të liruar nga pagesa për shërbime shëndetësore.
Shërbimet shëndetësore për PAK ofrohen mbi parimet etike dhe me respektimin e plotë të kulturës së individit, popujve dhe komuniteteve, gjinisë dhe të tjera-	NA	Rregulloret ekzistojnë por OPAK nuk kanë bërë hulumtime nëse ato zbatohen nga profesionistët mjekësorë.
Shërbimet shëndetësore për PAK ofrohen me cilësi adekuate shkencore dhe mjekësore, si dhe me sasi përkatëse	N/A	
Zhvillimi i programeve rehabilituese për të gjitha grupet e aftësisë së kufizuar--	E aplikuar	Në proces aprovimi i UA për ofrimin e rehabilitimit për PAK si dhe Ligji Gjithëpërfshirës.
Të gjithë personat me aftësi të kufizuara në nevojë duhet të kenë qasje në shërbimet e rehabilitimit	E aplikuar	UA për ofrimin e rehabilitimit të personave me aftësi të kufizuara dhe Ligji Gjithëpërfshirës.
Personat me aftësi të kufizuara dhe familjet e tyre marrin pjesë në zhvillimin dhe organizimin programeve dhe shërbimeve të rehabilitimit-	E aplikuar	OPAK të cilat ofrojnë shërbime/ Shërbimet e HandiKOS lidhur me rehabilitimin primar fizik.
Shërbimet e rehabilitimit ofrohen në komunitetin lokal ku jeton personi me aftësi të kufizuara-	E aplikuar	OPAK të cilat ofrojnë shërbime/ Shërbimet e HandiKOS lidhur me rehabilitimin primar fizik.
Zhvillimi dhe vlerësimi i programeve të rehabilitimit merr parasysh ekspertizën e ofruar nga organizatat e personave me aftësi të kufizuara-		

5. Punësimi dhe kujdesi social,

Punësimi dhe kujdesi social është vlerësuar përmes detyrimeve (standardeve) të cilat pak më shumë se një e treta (38,88%), e tyre janë përfshirë në legjislacionin e Kosovës, 44.45% janë adresuar pjesërisht ndërsa 16.66% mungojnë apo nuk janë adresuar fare.

Zbatimi i Ligjit dhe akteve Nënligjore për Aftësim, Riaftësim dhe Punësim të Personave me Aftësi të Kufizuara ka qenë fokusi kryesor për avokim nga organizatat e personave me aftësi të kufizuara gjatë vitit 2021. OPAK-ët në vazhdimësi kane kërkuar nga institucionet vendore, përmes takimeve, mediave dhe rrjeteve sociale, zbatimin e ligjit dhe realizimin e garancive që ofron ligji. Gjatë punës së tyre, Organizatat e Personave me aftësi të kufizuara kanë zbuluar se Ligji jo vetëm që nuk zbatohet nga sektori privat por ai nuk është duke u zbatuar në masë të madhe dhe ndër vite edhe nga institucionet publike të cilat do të duhej të shërbenin si shembull në respektimin e Ligjit. Në anën tjetër, si shembull i mirë në aspektin e respektimit të Ligjit për punësim nga ana e institucioneve shtetërore është Ministria e Punëve të Jashtme dhe Ministria e Znj. Donika Gërvalla e cila me iniciativë të sajë ka kërkuar takim me përfaqësuesit e OPAK për të shqyrtuar mundësitë e bashkëpunimit në mënyrë që kjo Ministri të përmbush obligimin e sajë ligjor lidhur me plotësimin e kuotës së punësimit të personave me aftësi të kufizuara në Ministrinë të cilën ajo drejton. Përfaqësuesit e OPAK sipas kërkesës së MPJ kanë dërguar listën me lidhur me profesionet apo pozitat në të cilat personat me aftësi të kufizuara do të mund të punësoheshin. Sipas informatave nga OPAK, pas përfundimit të procedurave të brendshme për strukturimin e vendeve të punës, MPJ do të shpall konkursin publik me qëllim të punësimit të personave me aftësi të kufizuara.

Në të njëjtën kohë është punuar edhe në gjetjen e alternativave sekondare për punësimin e personave me aftësi të kufizuara, p.sh. HANDIKOS gjatë vitit 2021 ka zbatuar projektin e financuar nga “Swiss Cooperation” zyra në Kosovë i cili përmes prodhimit të strajcave të tekstilit synon të zëvendësojë përdorimin e qeseve plastike, pra të promovoj mbrojtjen e ambientit por në të njëjtën kohë, të gjithë të punësuarit ishin personat me aftësi të kufizuara të cilët përmes këtij projekti arritën të gjenerojnë të ardhurat e tyre.

Nga të dhënat e pranura nga Organizatat e Personave me Aftësi të Kufizuara të cilat janë partnere të Projektit “Kosova Gjithëpërfshirëse”, të dhëna të pakonfirmuara zyrtarisht, rezulton se numri më i madh i personave me aftësi të kufizuara të cilët janë të punësuar i takojnë komunitetit të personave të shurdhër, kurse mbetet sfida e cila duhet adresuar punësimi i personave të verbër dhe atyre me aftësi të kufizuara fizike.

Sa i përket Kujdesit social, gjatë vitit 2021 MFPT dhe OPAK kanë punuar në akte nën-ligjore për të përkrahur kategori të ndryshme të aftësisë së kufizuar, prandaj gjatë vitit 2022 pritet (1) aprovimi dhe zbatimi i Udhëzimit Administrativ i cili e rregullon strehimin rezidencial të personave të rritur me aftësi të kufizuara mendore-ngecje në zhvillimin mendor, si dhe (2) hartimi i Udhëzimit Administrativ për rregullat dhe procedurat për mbulimin e shpenzimeve për edukim dhe shëndetësi për fëmijët me aftësi të kufizuara. Ky udhëzim do të hartohet sipas ligjit 06/L -084 për mbrojtje të fëmijës.

Në punëtorinë lidhur me hartimin e kalendarit të aktiviteteve për vitin 2022, të organizuar me përfaqësuesit e MFPT dhe Organizatat e Personave me Aftësi të Kufizuara në bashkëpunim me Zyrën për Qeverisje të Mirë dhe të përkrahur nga projekti i mbështetur nga BE “Kosova Gjithëpërfshirëse”, kjo Ministri ka informuar se në planet e tyre afat-shkurta është ndërtimi i dy shtëpive me bazë në komunitet, ku njëra do të jetë për strehim të personave të rritur me aftësi të kufizuara mendore dhe tjetra për strehim

të fëmijëve të braktisur dhe me aftësi të kufizuara. Në të njëjtën punëtori MFPT është zotuar se do të vazhdojë me thirrje publike për mbështetje financiare të OJQ-ve të licencuara për ofrimin e shërbimeve sociale për personat me aftësi të kufizuara. (Detalet për aktivitetet dhe veprimet tjera të cilat MFPT është zotuar se do ti realizoj janë prezantuar në tabelën Aneks 1 “Kalendari i Aktiviteteve për Vitin 2022”).

Për qëllimet e këtij raporti janë përfshirë detyrimet e mëposhtme:

Fushat e hulumtimit	Fusha e Intervenimit gjatë vitit 2021	Aktivitetet/Lloji i intervenimit
E drejta për të fituar të ardhura për jetesë nga një punë që u siguron qasje personave me aftësi të kufizuara	E aplikuar	Avokim për Zbatimit të Ligjit për Aftësimin, Riaftësimin Profesional dhe Punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara
Ndalimi i diskriminimit në punësim në bazë të aftësisë së kufizuar	E aplikuar	Avokim për Zbatimit të Ligjit për Aftësimin, Riaftësimin Profesional dhe Punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara ,
Mundësitë e barabarta në kushte të punës, pagesë, karrierë dhe mbrojtje nga ngacmimi/	E aplikuar	Avokim për Zbatimit të Ligjit për Aftësimin, Riaftësimin Profesional dhe Punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara ,
Qasja efektive e personave me aftësi të kufizuara në programet e arsimit profesional, mundësitë e punësimit dhe zhvillimin e karrierës	E aplikuar	Propozimet e dërguara nga OPAK lidhur me plotësimin e programeve të QAP për aftësimin e personave me aftësi të kufizuara për punë.
Punësimi i personave me aftësi të kufizuara në sektorin publik dhe privat/	E aplikuar	Avokim për Zbatimit të Ligjit për Aftësimin, Riaftësimin Profesional dhe Punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara
Mbrojtja e personave me aftësi të kufizuara nga puna e detyruar	NA	
Garantimi i standardit adekuat të jetesës për personat me aftësi të kufizuara dhe familjet e tyre (ushqim, veshmbathje, strehim)/	NA	
Qasja e barabartë e personave me aftësi të kufizuara në shërbimet e ujit të pijshëm/	NA	
Qasja e barabartë e personave me aftësi të kufizuara, veçanërisht e grave, vajzave dhe e të moshuarve me aftësi të kufizuara, në programet e përkujdesjes sociale dhe zbutjes së varfërisë	NA	
Mbështetje financiare dhe shërbimet e tjera për personat me aftësi të kufizuara dhe familjet e varfra	E aplikuar	Puna në Ligjin Gjithëpërfshirës dhe avokimi për Shërbime për personat e verbër.

Qasja e personave me aftësi të kufizuara në programet e strehimit social	E aplikuar	Hartimi i Udhëzimit Administrativ nga MFPT dhe OPAK lidhur me strehimin e personave me aftësi të kufizuara mendore.
Qasja e barabartë e personave me aftësi të kufizuara në programet e pensionit dhe benefitet.	E aplikuar	Takimet për me MFPT lidhur me pensionet e Personave me Aftësi të Kufizuara, veçanërisht gjatë pandemisë.

6. Pjesëmarrja publike,

Pjesëmarrja publike mbetet ndër kategoritë më sfiduese e standardeve të aftësisë së kufizuar, ku vetëm 20% e detyrimeve të mëposhtme janë përfshirë në legjislacionin e Kosovës, 20% e standardeve janë të adresuara pjesërisht, ndërsa 60% e standardeve mungojnë ose nuk janë të adresuara fare.

Organizatet e personave me aftësi të kufizuara kanë avokuar në vazhdimësi për pjesëmarrje në jetën politike dhe publike mbi baza të barabarta me të tjerët dhe për pjesëmarrje të plotë dhe jo diskriminuese në punët publike. Në referencë të kësaj të drejte, në zgjedhjet lokale të cilat u mbajtën gjatë vitit 2021, 11 persona me aftësi të kufizuara ishin kandidatë për Kuvende Komunale. Ky numër na bën të besojmë se do të krijohen kushte edhe më të mira për pjesëmarrje në jetën publike dhe politike dhe se rrjedhimisht numri i personave me aftësi të kufizuara në zgjedhjet e ardhshme do të rritet.

OPAK-ët, gjatë vitit 2021, kanë organizuar ngjarje të ndryshme për të shënuar Javën Ndërkombëtare të Njeriut me Shkop të Bardhë dhe Javën e Personave të Shurdhër, të përcjella me konferenca dhe takime me përfaqësues të institucioneve. Përmes aktiviteteve për ngritjen e vetëdijes, me 1 Mars 2021, është shënuar dita ndërkombëtare e përdoruesve të karrocave, kurse me 3 Dhjetor 2021 në bashkëpunim me Zyrën për Qeverisje të Mirë (ZQM) është organizuar konferenca në të cilën është prezantuar vendimi i Qeverisë së Kosovës për të shpallur vitin 2022 – vit të personave me aftësi të kufizuara. Aktivitete janë organizuar nga OPAK dhe për të shënuar 10 Dhjetorin, ditën ndërkombëtare të drejtave të Njeriut. Përmes këtyre organizimeve janë përçarur mesazhe për avancimin e të drejtave për personat me aftësi të kufizuara, zbatimin e ligjeve, qasshmërinë dhe gjithë-përfshirjen. Të gjitha këto ngjarje janë transmetuar në publik nga mediat vizuale, elektronike dhe mediat sociale.

Për qëllimet e këtij raporti janë përfshirë detyrimet e mëposhtme:

Fushat e hulumtimit	Fusha e Intervenimeve gjatë vitit 2021	Aktivitetet/Lloji i intervenimit
Personat me aftësi të kufizuara janë pjesë e jetës politike dhe publike mbi baza të barabarta me të tjerët (e drejta e votës dhe e zgjedhjes	E aplikuar	Pjesëmarrja e 11 personave me aftësi të kufizuara në zgjedhjet lokale të vitit 2021.
Personat me aftësi të kufizuara gëzojnë mjedis mbështetës për pjesëmarrje të plotë dhe jo diskriminuese në punët publike	E aplikuar	Avokim për mënjanimin e barrierave fizike për pjesëmarrje në jetën publike
Qasja e personave me aftësi të kufizuara në materialin kulturor/	E aplikuar	E përfshirë në Kalendarin e aktiviteteve për vitin 2022.

Qasja e personave me aftësi të kufizuara në programe televizive, filma, teatër dhe aktivitete të tjera kulturore/	E aplikuar	Prezenca me TV, Emisione informuese, aktivitete sportive. Interpretimi i lajmeve në gjuhën e shenjave.
Qasja e personave me aftësi të kufizuara në institucionet dhe monumentet e trashëgimisë kulturore.	E aplikuar	E përfshirë në Kalendarin e aktiviteteve për vitin 2022.

Në finalizimin e intervenimeve dhe realizimin e të drejtave nga këto fusha dhe avokimin dhe intervenimin për fushat e tjera do ta trajtojmë në vitet në vijim.

7. Zhvillimet e tjera

Gjatë muajit Prill 2021, HandiKOS organizoi fushatën “thuaj jo qeseve plastike”. Me qëllim të promovimit të përdorimit të qeseve të ri-përdorshme, miqësore me mjedisin, të prodhuara nga personat me aftësi të kufizuara, duke reduktuar përdorimin e qeseve plastike njëpërdorimshme dhe mbetjeve plastike. Kjo fushatë u organizua nga HandiKOS në bashkëpunim me OJQ “Ballkan Forum” dhe u transmetua në të gjitha stacionet televizive publike si dhe në mediat elektronike dhe sociale.

Gjatë muajit Gusht 2021 është mbajtur punëtorja me OPAK lidhur me zhvillimin e draftit të parë të Kalendarit të aktiviteteve për vitin 2022, më pas, gjatë muajit Shtator dhe Tetor 2021 në bashkëpunim me ZQM janë organizuar 6 punëtori me OPAK dhe Ministri relevante për të finalizuar draftin e dytë të kalendarit të aktiviteteve për vitin 2022.

Gjatë muajit Tetor dhe Nëntor 2021 janë kryer xhirimet e videos e cila promovon të drejtat e personave me aftësi të kufizuara. Video është publikuar me datën 3 Dhjetor 2021 dhe në të mesazhe përkrahëse për aftësinë e kufizuar kanë dhënë Kryetarja e Kosovës, Znj. Vjosa Osmani, Kryetari i Parlamentit të Kosovës parlamentari Zt. Glauk Konjufca, Kryeministri i Kosovës, Zt. Albin Kurti dhe Ambasadori i BE në Kosovë, Zt. Tomas Szunyog. Video është transmetuar nga të gjitha TV me frekuenca Nacionale dhe Lokale si dhe nga rrjeti social i HandiKOS.

Rekomandime për vitin 2022

1. Institucionet e nivelit qendror dhe lokal duhet të përfshijnë OPAK-ët në të gjitha fazat e procesit të planifikimit, dizajnit, zbatimit dhe monitorimit të veprimeve për rikuperim të përgjithshëm ndaj krizës së krijuar nga COVID 19, përfshirë ofrimin e shërbimeve të domosdoshme për personat me aftësi të kufizuar.
2. OPAK dhe zyra për Qeverisje të Mirë (ZQM) të bashkëpunojnë në procesin e përfshirjes së Konventës së Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara në Kushtetutën e Kosovës.
3. Të avokohet që institucionet publike të zbatojnë ligjin për punësimin e personave me aftësi të kufizuara përfshirë respektimin e kuotës për numrin e të punësuarve me aftësi të kufizuara (50=1).
4. Ministrinë, Institucionet qendrore dhe lokale të sigurojnë zbatimin e plote të legjislacionit aktual në Kosovë lidhur me qasjen, përfshirë këtu aktet nënligjore si Udhëzimi Administrativ 33/2007.
- 4.1 Të monitorohet respektimi i përmbushjes së kriterëve për qasjen në të gjitha kontratat e lidhura në prokurimin publik. Drejtoritë përkatëse komunale të monitorojnë zbatimin e kriterëve të Udhëzimit

Administrative 33/2007, për qasjen fizike në rastin dhënies së lejeve të ndërtimit për kompanitë e ndërtimit.

4.2 Institucionet qendrore dhe lokale të sigurojnë zbatimin e plote të Rregullores QRK Nr. 15/2014 për Ofrimin e Shërbimeve në Gjuhën e Shenjave në Republikën e Kosovës, është miratuar në mbledhjen e 197 të Qeverisë së Kosovës, me qëllim që personat e shurdhër të kenë qasje të plote në informata dhe shërbime.

4.3 MASHTI të sigurojë zhvillimin dhe zbatimin e sintezës vokale në gjuhën shqipe për personat e verbër në mënyrë që ky komunitet të ketë qasje në informata, edukim dhe shërbime.

5. Institucionet Arsimore të sigurojnë programe adekuate dhe qasje për përfshirjen e të gjithë fëmijëve me aftësi të kufizuar në procesin e rregullte arsimore në të gjitha nivelet.

5.1 MASHTI të sigurojë mësuesit/asistentet mbështetës në klasa për të gjithë llojet e aftësisë së kufizuar.

6. MFPT të sigurojë krijimin e mekanizmave për zbatimin e Ligjit për Aftësimin, Riaftësimin Profesional dhe Punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara.

6.1 MFPT të siguroj përfshirjen e Ligjit Gjithëpërfshirës në programin legjislativ për vitin 2022.

7. Të nënshkruhen marrëveshje mirëkuptimi me Transmetuesit e Mediave Publik që të rezervojnë një hapësirë kohore me fokus në aftësinë e kufizuar.

7.1 Të ngritën kapacitetet dhe njohuritë e gazetareve për çështjet e aftësisë së kufizuar,

8. Institucionet e Kosovës të ofrojnë mbështetje financiare dhe logjistike për anëtarësimin dhe pjesëmarrjen e OPAK-ve në rrjetet e organizatave ndërkombëtare të aftësisë së kufizuar.

9. Zyra për Qeverisje të Mirë të organizoj takimet e planifikuara dhe me kohë të Këshillit të Aftësisë së Kufizuar.

9.1. Zyra për Qeverisje të Mirë në bashkëpunim me OPAK të monitoroj dhe të përkrahë zbatimin e plotë të Planit Nacional të Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara 2021-2023.

9.2. Zyra për Qeverisje të Mirë në bashkëpunim me OPAK të monitoroj dhe të përkrahë zbatimin e plotë të Kalendarit të aktiviteteve për Vitin 2022.

Aneks 1. Tabela e “Kalendarit të Aktiviteteve për Vitin 2021”.

AKTIVITETET 2022			
A/A	Periudha kohore	Aktiviteti	Përgjegjësi
Komponenti 1 – SHËNDETËSIA			
1.1.	Janar- Dhjetor 2022	Përditësohet lista e barnave esenciale me nevojat e propozuara nga Organizatat e Personave me Aftësi të Kufizuara (OPAK).	Ministria e Shëndetësisë dhe OPAK
1.2.	Janar- Dhjetor 2022	Vendosja e monitorëve në hyrje (recepzione) të institucioneve shëndetësore (QKMF – Qendrat Kryesore të Mjekësisë familjare dhe Emergjencat në spitale regjionale dhe QKUK të cilët ofrojnë informata në gjuhën e shenjave	Ministria e Shëndetësisë dhe Shoqata e të Shurdhërve të Kosovës.
1.2.1	Janar- Dhjetor 2022	Sigurohet një numër telefoni kujdestarë i cili përmes “telefonave tabletë” ofron “online” shërbimet e interpretimit në gjuhën e shenjave në rastet kur personat e shurdhër i drejtohen institucioneve shëndetësore.	Ministria e Shëndetësisë dhe Shoqata e të Shurdhërve të Kosovës.
1.3.	Janar- Dhjetor 2022	Repartet e Neonatologji/Gjinekologjisë në QKUK dhe të gjitha Spitalet Regjionale pajisen me aparate të cilat mundësojnë identifikimin e hershëm të pengesave në dëgjim / humbjen e dëgjimit.	Ministria e Shëndetësisë
1.4.	Janar- Dhjetor 2022	Repartet e Gjinekologjisë në QKUK dhe spitalet regjionale pajisen me shtretër hidraulik për ekzaminime Gjinekologjike dhe Obstetrike të femrave me aftësi të kufizuara.	Ministria e Shëndetësisë
1.5.	Janar- Dhjetor 2022	Krijohet grup punues, i përbërë nga ministrinë e linjës (përkatësisht MSH, MASHTI dhe MFPT), përfaqësues të shoqatave të PAK-ve si dhe grupe të tjera të interesit për të krijuar formulën e cila do të mundësonte financimin dhe shtrirjen e shërbimeve të vazhdueshme për PAK.	Ministria e Shëndetësisë
Komponenti 2 – EDUKIMI & ARSIMI			
2.1	03 Dhjetor 2022	Ora e parë e mësimit në të gjitha shkollat fillore dhe të mesme të ultë (Dita Ndërkombëtare e Aftësisë së Kufizuar) i kushtohet aftësisë së kufizuar	MASHTI, DKA Shkollat
2.2	Janar- Dhjetor 2022	Ndërtimi i pjerrinave në 10 shkolla fillore të mesme të ulëta dhe 5 shkolla të mesme të larta në 15 komuna	MASHTI, DKA
2.3	Janar- Dhjetor 2022	Punësimi i dy mësimdhënësve për Brail dhe “Orientim & Mobilitet” për fëmijët e verbër në shkolla	MASHTI
2.4	Janar- Dhjetor 2022	Inicimi i procesit për krijimin e Sintezës Vokale në Gjuhën Shqipe	MASHTI
2.5.	Janar- Dhjetor 2022	Akreditimi i programit për shkrim në Brail dhe ofrimi i trajnimeve për mësimdhënës	MASHTI, SHKSH, AKK, Qendra Burimore “Nënë Tereza”
2.6.	Janar- Dhjetor 2022	Punësimi i 100 asistentëve në shkolla për fëmijët me aftësi të kufizuara.	MASHTI, DKA, Qendrat Burimore

		Punësimi i 3 (tre) asistentëve të gjuhës së shenjave në Qendrën Burimore “Nëna Terezë” në Prizren, për të mbështetur fëmijët e shurdhër.	
2.7.	Qershor - Gusht 2022	Zhvillimi i planit për ofrim të arsimit joformal në Qendrave Burimore për fëmijët dhe të rinjtë me aftësi të kufizuara.	MASHTI, Qendrat Burimore, OPAK
2.8.	Janar- Dhjetor 2022	Funksionalizimi dhe ngritja e kapaciteteve të Ekipeve Vlerësuese Pedagogjike në komuna	MASHTI, DKA, OPAK, Këshilli i Evropës
2.9..	Shkurt-dhjetor 2022	Hartimi i instrumenteve për identifikimin dhe vlerësimin e vështirësive në të nxënë nga psikologët në shkolla.	MASHTI, Departamenti i Psikologjisë (UP), DKA, shkollat, Këshilli i Evropës
2.10.	Janar- Dhjetor 2022	Akreditimi i gjuhës së shenjave si gjuhë e dytë amtare	MASHTI, SHKSH, Qendra Burimore “Nënë Tereza”, Këshilli i Evropës
2.11.	Janar- Dhjetor 2022	Akreditimi i kualifikimit (niveli i 5-të) për Interpret i gjuhës së shenjave	MASHTI, Këshilli i Evropës
2.12.	Janar- Dhjetor 2022	Trajnimi i drejtorëve dhe mësimdhënësve të arsimit të mesëm të lartë për qasjen dhe arsimimin e nxënësve me aftësi të kufizuara.	MASHTI, DKA, Shkollat, Këshilli i Evropës
2.13.	Janar- Dhjetor 2022	Trajnimi i mësimdhënësve të 25 shkollave mbi qasjen dhe arsimimin e nxënësve me aftësi të kufizuara.	MASHTI, DKA, Shkollat, Këshilli i Evropës
Komponenti 3 – PUNËSIMI			
3.1.	Janar- Mars 2022	Vendim i Kryeministrit i cili bazuar në ligjin për Aftësim, Riaftësim dhe Punësim të Personave me Aftësi të Kufizuara obligon institucionet që gjatë vitit 2022 të plotësojnë kuotën për punësimin e PAK!	Zyra e Kryeministrit
3.2.	Janar- Dhjetor 2022	Obligohet inspektorati i punës për inspektimin e zbatimit të ligjit nga ana e institucioneve për punësimin e PAK.	Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
Komponenti 4 – QASJA			
4.1.1	Janar- Dhjetor 2022	Të rregullohet qasja fizike në objektet/qendrat për patentë shofer (ndërtesat ku organizohen provimet për tu pajisur me patentë shofer);	MMPHI
4.1.2	Janar- Dhjetor 2022	Brenda auto shkollave, të ketë edhe një automjet të qasshëm për personat me aftësi të kufizuara në tërë komunat e Republikës së Kosovës;	Grupi punues për hartimin e UA për licencimin e auto-shkollave.
4.2.1	Janar- Dhjetor 2022	Të furnizohet aeroporti i Prishtinës me karroca standarde që përdoren brenda aeroplanit për vendosje dhe zhvendosje të personave me aftësi të kufizuara.	Departamenti i Aviacionit Civil
4.2.2	Janar- Dhjetor 2022	Zyra informuese për pasagjerë të pajiset me një tabletë (I-Pad) për komunikim me interpretuesin e gjuhës së shenjave.	Departamenti i Aviacionit Civil
4.3.	Janar- Dhjetor 2022	Trafiku ndër-urban, autobusët, të sigurojnë qasshmëri (të përshtatin autobusët me rampa/pjerrina, informim në audio) për Persona me Aftësi të Kufizuara;	MMPHI

4.4.	Janar- Dhjetor 2022	Në procesin e licencimit të përfshihet kriteri për operatorët e taksive të posedojnë së paku një veturë të qasshme (me rampë/pjerrinë) e cila u mundëson transportin edhe të personave me aftësi të kufizuara;	MMPHI
4.5.	Janar- Dhjetor 2022	Në 5 Komuna të Kosovës do të identifikohen pengesat/barrierat dhe vlerësohet qasshmëria e një rrugë/ambienti të hapur apo sheshi, me dizajnë dhe kosto;	MMPHI
4.6.	Janar- Dhjetor 2022	Zhvillimi i sinjalistikës vizuale dhe auditive me qëllim udhëzimin e personit me aftësi të kufizuara intelektuale dhe autizëm.	MMPHI
Komponenti 5 – MIRËQENIA SOCIALE			
5.1.	Janar- Dhjetor 2022	Ligji për kodin doganor dhe të akcizave të Kosovës, të përfshijë edhe shoqëruesit e fëmijëve dhe të rriturve me aftësi të kufizuara të cilët nuk kanë mundësi të ngasin veturë dhe të ju mundësojë lirin nga importi dhe akciza për vetura për nevojat personale;	Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
5.2.	Janar- Dhjetor 2022	Të lirohen nga dogana dhe akciza edhe automjetet të shoqatave të personave me aftësi të kufizuara të cilat janë të qasshme dhe të përshtatura për ofrimin e shërbimeve;	Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
5.3.	Janar- Dhjetor 2022	Projektligji për Vlerësimin, Njohjen e Statusit, Përfitimet dhe Shërbimet për Personat me Aftësi të Kufizuara, të aprovohet dhe fillojë zbatimin;	Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
5.4.	Janar- Dhjetor 2022	Të ri formatohen dhe të ngritën kapacitetet e Komisioneve Vlerësuese për personat me aftësi të kufizuara;	Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
Komponenti 6 – KULTURA DHE SPORTI			
6.1.1	Janar- Dhjetor 2022	Mbështetja e programeve sportive për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe përfshirja e sportit në arsimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara.	MKRS – Departamenti i Sportit
6.1.2	Janar- Dhjetor 2022	Trajnimi i instruktorëve të sportit për Personat me Aftësi të kufizuara (Organizatat do të identifikojnë në Projekt Propozim për cilat sporte).	MKRS – Departamenti i Sportit
6.1.3	Janar- Dhjetor 2022	Sigurimi i pajisjeve sportive për sportet e personave me aftësi të kufizuara, përmes hartimit të një projekt propozimi	MKRS – Departamenti i Sportit
6.1.4	Janar- Dhjetor 2022	Inicimi i themelimit të garës së basketbollit në karroca (Me MKRS dhe Federatën e Basketbollit).	MKRS – Departamenti i Sportit
6.1.5	Janar- Dhjetor 2022	Përkrahja e organizimit të turnirit regjional të basketbollit në karroca (nga një ekip nga Shqipëria, Maqedonia e Veriut, Mali i Zi dhe Kosova).	MKRS – Departamenti i Sportit
6.1.6	Janar- Dhjetor 2022	Pjesëmarrja e Personave me aftësi të kufizuara në lojërat paralimpike duke mbështetur programet trajnuese për sportistët.	MKRS – Departamenti i Sportit
6.2.1	Janar- Dhjetor 2022	Mbështetja e organizimit të një shfaqje teatrore në gjuhën e Shenjave;	MKRS – Departamenti i Kulturës

6.2.2	Janar- Dhjetor 2022	Përfshirja e temës së aftësisë së kufizuar, në programin e Teatrit Kombëtar të Kosovës, përmes shpalljes së një konkursi për skenar teatror me temën ngritja e vetëdijes për mundësi të barabarta për të gjithë.	MKRS – Departamenti i Kulturës
6.3.1	Janar- Dhjetor 2022	Lehtësimi qasjes për personat me aftësi të kufizuara në institucionet e kulturës (muze, galeri, teatro, kinema, salla koncertesh dhe të tjera) dhe ndjekja e programeve të tyre përmes përdorimit të arritjeve të teknologjisë moderne;	MKRS – Departamenti i Kulturës
6.3.2	Janar- Dhjetor 2022	Sigurimi i qasjes dhe pajisja e muzeumeve (muzeut Kombëtar të Kosovës) me monitorë informues në gjuhën e shenjave, nga ana e Ministrisë së Kulturës	MKRS – Departamenti i Kulturës
6.3.3	Janar- Dhjetor 2022	Plotësimi dhe rishtypji i Katalogut të Muzeut Kombëtar të Kosovës në alfabetin Brail me imazhe taktile.	MKRS – Departamenti i Kulturës
6.3.4	Janar- Dhjetor 2022	Pajisja e Muzeut Kombëtar me një monitor që informon për gjuhën shenjave. Monitorë propozohet të vendosen edhe në Kompleksin e LSHP-së dhe në Muzeun Arkeologjik në Prizren.	MKRS – Departamenti i Kulturës
6.4.	Janar- Dhjetor 2022	Trajnimi dhe ngritja e kapaciteteve për hartim, zbatim dhe menaxhim të projekteve të organizata dhe individëve me nevoja të veçanta për aplikim në fondet publike.	MKRS – Departamenti i Kulturës
6.5	Janar- Dhjetor 2022	Funksionalizimi dhe mbështetja e bibliotekës për personat e verbër.	MKRS – Departamenti i Kulturës
6.6.1	Janar- Dhjetor 2022	Organizimi i javës së filmit për Persona me Aftësi të Kufizuar (me temë aftësinë e kufizuar);	MKRS – Departamenti i Kulturës
6.6.2	Janar- Dhjetor 2022	Shpallja e konkursit për skenarin e filmit dokumentar apo film të shkurtë me temë “Aftësinë e Kufizuar”.	MKRS – Departamenti i Kulturës
6.6.3	Janar- Dhjetor 2022	Ministria e Kulturës si mbështetëse e “Dokufest” do të rekomandojë drejtuesve të këtij festivali përfshirjen e filmave dokumentar me temë aftësinë e kufizuar.	MKRS – Departamenti i Kulturës
6.7.1	Janar- Dhjetor 2022	Organizimi i një kampi për të rinj në të cilin do të bëhet prezantimi i kulturës së të shurdhërve dhe gjuhës së shenjave (me pjesëmarrje gjithëpërfshirëse);	MKRS – Departamenti i Rinisë
6.7.2	Janar- Dhjetor 2022	Mbështetja e aktiviteteve sportive në mes të rinjve me dhe pa aftësi të kufizuara;	
6.7.3	Janar- Dhjetor 2022	Mbështetja e “Kuizit të diturisë” për të rinjtë me aftësi të kufizuara;	MKRS – Departamenti i Rinisë
6.7.4	Janar- Dhjetor 2022	Mbështetja e Projekteve për industri kreative – artizanale;	MKRS – Departamenti i Rinisë
6.7.5	Janar- Dhjetor 2022	Mbështetja e programeve të trajnimit për të rinjtë me aftësi të kufizuar; (përmes programeve të trajnimit për ndërmarrësi dhe trajnimeve për “soft-skills”).	MKRS – Departamenti i Rinisë
6.7.6	Janar- Dhjetor 2022	Mbështetja e të rinjve me aftësi të kufizuara për vetëpunësim	MKRS – Departamenti i Rinisë

6.8.	Janar- Dhjetor 2022	Themelimi i grupit punues për hartimin e Planit të Veprimit për Kulturë, Rini dhe Sport për personat me Aftësi të Kufizuara. Gjatë vitit 2022 krijohet grupi punues në përbërje të përfaqësuesve të MKRS dhe Organizatave të Personave me Aftësi të Kufizuara për të hartuar draftin e Planit pesë vjeçar të veprimit për KRS 2023-2027.	MKRS dhe OPAK
Komponenti 7 – DREJTËSIA DHE SIGURIA			
7.1.	Janar- Dhjetor 2022	Hartimi i udhëzuesit informues për të drejtat e personave e aftësi të kufizuara në sistemin e drejtësisë.	Ministria e Drejtësisë
7.2.	Janar- Dhjetor 2022	Trajnimi i stafit në Shërbimet Sprovuese dhe Korrektuese	Ministria e Drejtësisë
7.3.	Janar- Dhjetor 2022	Mbrojtja ligjore e Personave me Aftësi të Kufizuara – Gjykatat, Prokurorët, (Akademia e Drejtësisë përfshin një Moduli për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara në programin e tyre të trajnimit).	Ministria e Drejtësisë
7.4.	Janar- Dhjetor 2022	Ministria e Drejtësisë në bashkëpunim me Organizatat e Personave me Aftësi të Kufizuara organizojnë një punëtori lidhur me veprimet të cilat duhet të ndërmerren në rastet kur nuk zbatohet ligji nga Institucionet publike/shtetërore.	Ministria e Drejtësisë
7.4.1	Janar- Dhjetor 2022	Njohja e të drejtës së PAK për të shfrytëzuar të drejtat ligjore në baza të barabarta me të tjerët.	Ministria e Drejtësisë
7.4.2	Janar- Dhjetor 2022	Informimi i personave të shurdhër për të drejtat e tyre ligjore.	Ministria e Drejtësisë
7.4.3	Janar- Dhjetor 2022	Shërbimet te Noteri lidhur me autorizimin e personit të shurdhër (PAK)	Ministria e Drejtësisë
7.4.4	Janar- Dhjetor 2022	Rregullimi i përdorimit të gjuhës së shenjave te Noteri	Ministria e Drejtësisë
7.5.	Janar- Dhjetor 2022	Ndërmarrja e masave për ti ofruar qasje PAK në mbështetjen e nevojshme për të ushtruar të drejtat e tyre ligjore.	
Policia e Kosovës			
7.6	Janar- Dhjetor 2022	Krijimi i grupit punues në mes të Shoqatës Kosovare të Shurdhërve dhe Policisë së Kosovës (IT ekspertët) për të gjetur modalitetet e kontaktimit të Policisë dhe numrave të tjerë emergjent nga personat e shurdhër.	Policia e Kosovës dhe OPAK
7.7	Janar- Dhjetor 2022	Të organizohet një takim pune (punëtori) në mes të përfaqësuesve të Policisë dhe Shoqatës Kosovare të Shurdhërve për hartimin dhe publikimin e informuesit për të shurdhëritë – lidhur me informimin për dënimet në komunikacion!	Policia e Kosovës dhe OPAK
7.8	Janar- Dhjetor 2022	Takim pune me divizionin e trajnimeve brenda Policisë për të ri-freskuar/ përditësuar të drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara në programin e trajnimeve të policëve.	Policia e Kosovës dhe OPAK

7.9	Janar- Dhjetor 2022	Konferencat e Policisë për media të nivelit kombëtarë të sigurojnë informimin në gjuhën e shenjave!	Policia e Kosovës dhe OPAK
7.10	Janar- Dhjetor 2022	Procedurat Standarde të Veprimit (PSV apo SOP) për rastet kur kryes të veprës janë personat me aftësi të kufizuara.	Policia e Kosovës dhe OPAK
7.11	Janar- Dhjetor 2022	Ngritja e kapaciteteve të Policisë së Kosovës përmes Trajnimit të zyrtarëve të policisë për mbrojtjen dhe ndihmën e viktimave me aftësi të kufizuara dhe mbi specifikat e Personave me aftësi të kufizuara.	Policia e Kosovës dhe OPAK
	3 Dhjetor 2022	Konferenca Vjetore	ZQM dhe OPAK